Vëllim Poetik

Nga Arqile V.Gjata

Gratë e poetëve

poezi

Redaktor
Grigor Jovani
Korrektor
Vangjel Pici

Kopertina
Olja Kotti

E-mail : leagjata@gmail.com
www.arqilegjata.blogspot.com
Telefon +306939353954

Falenderoj Shoqatën Atdhetare të Emigranteve Shqipëtarë në Greqi « Vëllazërimi » që bëri të mudur sponsorizimin e botimit të librit.

Në vënd të parathënjes

Shpirtdhimbja e poetit që krijon bukurinë në fjalë

Nga Fatmir Terziu

Mu deshën pak kohë që të lexoja poetin Arqile Gjata . E pashë poezin e tij në vite pashë edhe energjinë e tij të veçantë . Është një poetikë që delnga shpirti, nga ndjenja, nga të gjitha anët e komponentit përbërës të shpirtit të tij të dhimbshëm, përvuajtës . Mësë fundi rilexova ciklin më të ri të tij, ''Nata e dhimbjes'' dhe fiksova sërish këtë poet që flet qartë, që ka stilin, gjuhën dhe vargun e tij . Është një poet që krijon dhe lëvron vargjet e lira, sepse ato janë të çliruara nga metri, dhe pse natyra e çiltër e tij është e tillë, e lirë, e çliruar nga gjetja dhe humbja e kohës , Vargu i poezisë së tij në tëshumtën e rasteve është i çliruar nga ritmi i regulltë, por ka në thelb ritmin fjalëmesazhier, është i çliruar nga rima, por ka sensin e një të lexuari të rrjedhshëm, me nge, kuptueshëm . Në poezinë e Gjatës, gjejmë muzikalitetin e një poezie me varg të ndërlikuar që mbështetet në organizimin e njësive ritmike të rëndësishme dhe në ritmin që organizon njësitë kuptimore dhe tingëllore .
Mjafton të lexosh ciklin e tij të fundit dhe të kuptosh këtë . Tek poezia '' Fjalët'' e gjejmë atë dukshëm . Tercina(strofa treshe) e tij flet qartë .

'' Kur fjalët bëhen re të zeza,
e vijnë me pickima mbi dritaret e shpirtit,
ato bëhen gra të përdala…''

Dhe po ta shohësh këtë poezi se është realizuar në Athinë më 8-11-2008 ora 20 ;40, Natyrshëm e kupton edhe shpirtin e përdhimbur të potit, shpirtin e një krijuesi që tashmë flet qartë dhe ka gjuhën e tij të vërtet, tipike . Me ndjenjën e leximit të poezisë së tij dhe me ndjenjën e një poezie që më ndjeu pash se vargjet e tij janë një peshë e rëndësishme fjalësh që ashtu si atëhere kur u shfaqën në poezinë evropiane me emërtimin në gjuhën franceze(ku dhe ka lindur) verslibre-varg i lirë . Këto vargje lindën atëhere si shprehje e nevojs së bredëshme të poetit, si domosdoshmëri e srukturimit të përmbajtes, dhe tashmë në ciklin e Gjatës kanë një arsye më shumë të lindin dhe të fiksohen si të tilla, pasi ato pasqyrojnë botën e tij të brendëshme e të ndjeshme . Ky strukturim i tij në poezi lidhet me

poezinë moderne, që ushqehet pikërisht nga rrethana të tilla .
Por këto shenja të tilla poetike, që shmangen nga tradita e vargëzimit i gjejmë edhe në poezi të tjera të këtij cikli dhe të krijimtarisë së tij .

Madje ato kanë lidhje
me krijimtarin e hershme poetike shqiptare që tentoj këtë shmangje nga

tradita e vargëzimit . Asdreni te ‘’Psallme murgu ‘’(1930) krijoj dhe strukturoj në këtë mënyrë . Kadare krijoj ‘’Llora’’ dhe në mënyrë prefekte realizoi një dukuri që tashmë duket e zakonshme në poezinë e Gjatës . Poezia ‘’Llora’’ e Kadares ka ngjashmëri në strukturë dhe në filozofinë e shprehjes me poeznë e Gjatës, ‘’Poetët e harlisur’’.

‘’ Poetët e harlisur
brigjeve të fjalës,
dhëndur të poezisë syshkruar,
mos ma prishni buzëqeshjen e varrit të nënës .
Nga cepat e vargjeve rrëshqasin lotë dhe shpresë,
Jo copra litari për fjalën e lirë….’’

Duke parë poezinë e Gjatës në kënd më të ngushtë, shikon edhe Fuqinë e personifikimit të tij poetik, që krijohen në lidhje të ngushtë me shpirtin e tij, me ndjeshmërinë e tij . Janë ‘’dhëndur të poezisë syshkruar’’ që poeti u vesh poezive syshkruara, këtyre gjërave pa shpirt, sikur ndjejnë dhe janë tamam ajo plotsja e shpirtit dhe ndjnjës së poetit .
Një tipar tjetër dallues në këtë cikël poetikë të krijuar nën peshën emocionale është edhe elokucioni, që ka të bëjë me zgjedhjen e fjalëve dhe vendosjen e tyre në varg, në mënyrë të tillë që të ushtrojnë ndikim **sa më të madh . Dhe këtu shihen qartë, sidomos tek poezitë ‘’Pagjumësia’’ ‘’Rrugëve të fjalës’’, ‘’E shkriva moshën’’- siç janë shprehësia, veçantia, pastërtia gjuhësore, eleganca, veçantia ideale, harmonia etje.**
Stilistika letrare e poezisë së Gjatës është një funksion i qartë dhe një harmoni e nevojshme në lidhje me gjithë detajet e poetikës . Këtu merr jetë poezia e tij dhe mbetet si një krijim ritmik i botës së tij të brendëshme e të **ndjeshme , Edgar Allan Poe thotë :’’ Poezia është krijimtari ritmike e së bukurës në fjalë ‘**’
Dhe këtë e kryen edhe poezia e këtij poeti në shpirtdhimbje .

16 – Nëntor – 2008 Posted by M.I.P

Cikli I parë

Duke soditur gratë e poetëve

Gratë e poetëve

Vijnë gratë e poetëve
palë-palë,
mbushur shpirtin me këngë.

Këto gra me luk të ndryshuar,
ditë e natë përtypin ëndrra
për burrat e trullosur nga frymëzimet.

Gratë e poetëve, idilike,
"Natyrë e qetë" në kopshtin me ajër të poezisë ,
feksin si mollë e ndalueme,
shëmbur mbi shtrat, të joshura
nga dashuria e burrave poetë.

Nuk u del shpirti pa u botuar libri
me fjalor muzike
"Gratë janë fajtore".

Prill 2007

Në muzeun e monumenteve

Gurë dhe gurë, deri lart në majë.
Butësisht, si pëllumba të fjetur,
statuja të gurta më përshëndesin.

Skelete monumentesh derdhur nëpër shesh,
ku rishpiket jeta e puthur nga vdekja.

Statujat më buzëqeshin.
Dhe pse s'më flasin, ndihem i lumtur.

Në këtë fushë gurësh,
druhem t'i zgjoj monumentet...
Nuk i prek dot,
mos shpirti më mbetet në një libër guri.

Pallati që ra

Pranë këmbëve të mia
rritej një pallat.
Pas disa vitesh, ballkonet
u vodhën nga zyrtarë të lartë.
Banorët
nuk ngopeshin se ngrëni suvatë.
Skeleti i pallatit donte dritë....
- Ta rrëzojmë pallatin!- thanë banorët.
Kur pallati ndërronte frymëmarrje,
pa pritur ra...
Për çudi,
banorët hyjnedilnin në shtëpi,
ashensori punonte si më parë…

Shkurt, 2007

Kohë fëmijërie

Duke luajtur me veten,
kohë të kaluara më trokasin në sy.
Era e fëmijërisë - një e qeshur
e largët, tretur në lëngun e jetës,
më ledhaton sa herë jam i pafuqi.

Në një mbrëmje poetësh

Njerëzit,
në një mbrëmje dëfrimi na thanë:
- Pagjumësia e poetit
çlodhet nga ëndrrat e grave
veshur me kostume nate,
e mbështjellë e tëra
nga puthjet e dritës,
në kërkim të grave me kapele
të dehura nga aroma e ditëve
të qershorit,
me muzikë zbavitëse për njerëzit
e ajrit alpin që,
si skelete në lundrim
i afrohen fantazisë
së grave afrodizjane.
Kështu na thanë njerëzit
e ajrit
në një mbrëmje poetësh.

prill 2007

Të vdes i dashuruar

Në çdo agim,
askush nuk e di pse duhet të ndahet
nga jeta e rrezikshme dhe e bukur.
Bëjmë mirë që s'e kujtojmë...
Vdekja na buzëqesh,
kur kemi humbur guximin,
fytyrën e gjithë dashurive.

Nuk dua të iki nga kjo jetë,
ditët e bardha të dashurisë,
kujt t'ia lë?
Nuk dua të mbetem natë e përjetëshme
dhe bashkë me mua jeta e shëmtuar.
Dua të vdes pranë oxhakut të dashurisë.

Në ditëlindjen tënde

Sot
është ndezur qielli
nga gulçimat e frymëmarrjes.

Bëlbëzojnë zogj,
që shpejtojnë
të gjejnë folenë
tek buzët e tua.

E dashur,
po vi tek ty fluturimthi !

Balladë

(Në kujtim të poetes Milla Bala)

Në Athinë
jeton një pemë me gjethe
të patretura tingujsh.

Hedh hapin
e pak viteve të shkuara,
në ditët e poezisë së Millës...

Mbretëreshë e Egjeut!

Noton nëpër det,
herë si dallgë
dhe herë si këngë.

Shpirti yt,
krijesë ëndrrash,
kartolinë për poetët.

Milla!

Shumë mote s'na buzëqesh,
flokët e fotografisë
na kanë mbetur ndër sy.

Ti ike,
por zogjët e vargjeve të tu
vazhdojnë këngën gojë më gojë.

Të kërkojmë mes vargjesh
të të themi: sot këtej nga ne ka festë.
Ti je këtu pranë...

Na dëgjon?

Apo lodron nëpër re,
me buqeta vargjesh
mbledhur në lotin e dhimbjes!?

Cikli i dytë
(qershor–korrik 2008)

Çudi të thjeshta

Valsi i Diellit

-triptik-

1.
Në flladin e buzëve të mia
një zonjë
vallëzon *"Valët e Danubit"*.

Me hënën vallëzon,
si peshk i artë në një oaz
ngopur me dritë…

2.
Dhe në pleqëri,
si zogj të lumtur,
nëpër vreshta vallëzojnë ata,
që rrjedhin në rrugët e diellit.

Gjithçka është e shtruar me fruta
dhe gurë.

Me flokë bore mbuluar
tërë lulet e kopshteve
këngëtarë
do shkojnë të kërcejnë vals
si dikur.

Pa sy, si xixëllonja,
do flenë në shtratin e heshtjes,
me radhë, një e nga një…

3.
Eja, e dashur !
Të shkojmë të kërcejmë vals përsëri.
Në shpirtin tonë nuk ka pleqëri.

Këngët e detit të përjetshme mbeten

Nuk lodhem të tregoj për aromën
e viteve të shkuara.
Për ëndërrimet e netëve të mia,
ku këngët e detit të përjetshme mbeten
dhe shpirti i përndan kudo ku ka jetë.
Është drita e thellësive që i pjek dallgët
me iso vikasin,
si daullet e fiseve detare.
Tërë detet e botës nuk mund të avullojnë.
Përsëri, mjegulla dhe tramundana
prej hënës shtrydhin mëngjese,
ku thjeshtësia dhe luksi i detit
ruajnë gjithë të fshehtat e kohërave.
Nën valët e detit prehen hyjnesha
të lindura nga syri i thellësisë,
me gojën hapur shpirtin freskojnë.

qershor, 2008

Kur shoh ëndrra…

Kur shoh ëndrra
dëgjoj këngët e gjinkallave,
bashkuar me korin madhështor të milingonave
dhe fërfërimën e lehtë të breshkave
nëpër ugare.

* * *

I nxitoj sytë përpara, drejt ëndrrave…
Zemra endacake e zbathur
më bredh nëpër sokaqe,
që nuk kanë vdekur në këtë jetë,
e gjej syrin e kohës së qytetit
ndërtuar që kur lindën
portat e shtëpive,
në Sheshin e Kateqit,
në Vlorën time.

korrik, 2008

Poetët

U nisën nxitimthi me erërat.
Poetë të mençur dhe jo normalë
krehin muzat,
tresin dhjamin e ëndrrave,
bëjnë dashuri si të verbërit….

Në ajrin plot smog
me buzëqeshje të gjata sa nata
zogj të ngrirë përgatisin darkën
për poetë e shkrimtarë plot brenga,
me shpirt të butë
mërmërisin për ata që do mbeten…

I urituri

Në një copë diell të ngritur mëngjesor
i urituri zë një vend të çuditshëm
mbushur me ndjenja shprese.
Jeta i shpaloset nëpër rrugë,
si një frymëmarrje zgjat dorën
në pritje për të gjetur dritën e heshtjes…
Me sy gjysëm të mbyllur
sodit hijet e kalimtarëve,
nga uria përton t'i shikojë në sy.
Ulur mbi ngjyrat e ditës
prek shkëndija çastesh...
Poshtë,
nën vete pllaka guri të mbërdhira,
që nuk kanë vdekur.

Qeni

Lidhur para pasqyrës
një qen budalla.
I gëzohej vetvetes.
Nga kënaqësia
ngre këmbën të shurojë pasqyrën,
kur sheh fytyrën e të zonjës.

Çudia

Jam çuditur,
si flenë kafshët dhe insektet.

Në mëngjes, në mbrëmje,
në ditë feste - të paveshura,
ngrihen nga gjumi plot ngjyra.

Kur u veshin rroba,
qajnë me ngashërime,
shëmtohen deri në vdekje.

Çudi të thjeshta,
si vetë jeta.

Kur linda…

Atë natë kur linda,
nata e kishte varur hënën.
Kur linda
bëhej vrasje në Evropë.
Kur linda,
në qytet njerëzit ishin në shpërgjumje.
Kur linda,
ushtarët fatzinj trëmbeshin në gjumë.
Kur linda,
fëmijë të deformuar,
as qanin, as qeshnin.

Në verë

Në pyllin e gjelbër shtruar në të verdhë,
në verë,
gjatë vapës
nga ajri rrëzohen shpendë të ngordhur.
Poshtë,
në tokë
kafshë të uritura
nga etja duartrokasin shiun,
që sjell hedhurina ditëve të nxehta.

Siborës

- Vajzës sime -

Çast pas çasti
qeshin muret e shtëpisë.

Pemë e ujitur nga zemra të urta
ngjitet dhe rritet
si koha shpërndarë nëpër qiell,
lis i gjatë dëshirash.

Ikona ime e shenjtë!

Njeriu

Njeriu,
grindur nga pluhuri i kohës,
fotografon realitetin…

Ai,
si qytet i vetmuar,
mbushur me sirtare kujtimesh,
nën qerpikët e rrezeve të diellit,
brenda shpirtit prek,
përkëdhel dashurinë.

Unë

I dehur,
me mendime kryqëzuar,
kërkoj realitetin endacak.

Në botën e lirë,
gojë më gojë,
pa dhimbje dhe fymëmarrje,
i gëzohem verbërisë së jetës.

Cikli i tretë
(korrik-tetor, 2008)

Vizatime në kujtesë

Disa çaste pranë një UFO- je

U gjënda pranë një UFO-je,
t'i them fal me shëndet
asaj krijese.

Me fytyrë rrëshqitëse
flinte mbi fijet e barit,
si qënie pa gjak.

Shëmbëlltyra e tij prej dylli
e ndali rrjedhën
nga hëna me kostum rivjere.

Prej qiellit rrëzohej nata,
mes mureve braktisej heshtja.
Gjithçka humbte, tretej.

Qielli dhe deti më s'u panë.
Ai u ngjit tinzisht përpjetë,
fantazmë në një udhëtim nëpër re.

Në ç'qiell shkoi!?

Një detar

Te ai klub pranë molit shkoja shpesh,
me dëshirë të dëgjoja bisedat e marinarëve
të porsa ankoruar.
Ata,
ngrohur dhe shkopsitur nga dielli,
duan muzikë e dëfrime.
Një grua e stolisur
kërkon të thajë qerpikët
me epshet e tyre.
Përballë saj një detar,

si peshk i porsa kapur,
me frymëmarrje të thellë,
i ngurtësuar si memec,
nga paniku se,
nuk mund të flinte me të dashurën,
lakuriq si peshqit,
përfund detit.

Qyteti im

Je i shtrenjtë në shpirtin tim,
qyteti im bujar.
Ti përhap kaltërsinë e ajrit,
ti qesh e loz, si në kohë të rinisë.

Por, këtë radhë vrapoj i lodhur,
drejt teje përkundem plot mall
për njerëzit e ikur.

I trubulluar roj me kujtime
për ata që s'munda
t'i përqafoja për së gjalli.

Korrik-2008

Gruaja

.
E dashura ime me zemër dhe mendje,
në mosmarrëveshje me veten.
Grua me shije dhe flokë të prera me kohën,
me buzë të lëshuara për vuajtje.

Pasqyra e rrëfen me trup e shpirt plot halle.
Ajo ikën,
të jetojë me ëndërrime,
me sy të lotuar jep përgjërime…

Gjithmonë e heshtur gjelbëron .

korrik-2008

Bie borë

Bie borë e bardhë mbi ne.
Mjegulla dhe murnaja mbylli rrugët e ngrira.
Nata e bardhë,
si një bukuroshe e harbuar,
me epshe ujëbore
një tango të ndjeshme pranë zjarrit vallzon
me flakë puthjesh deri në pafjetësi…

Kështjella e Porto Palermos

Pre e haresës Kështjella e Aliut.
Dritëtretur,
nën petkat e legjendës.

* * *
Me pasion romantik sodis hijet e skllaveve…
Shpërgjumur gurëve të kështjellës
gremisur ndër vite,
thellë në bimësinë e mureve.
Unë, anonimi i sotëm,
si në kohëra të ngjajshme
gdhendur ndër bedena,
mbi shpatulla kam hedhur misterin e detnajës,
që qarkon Kështjellën e Vasiliqisë
me shpresë se muret do të flasin…….

18 gusht 2008

Skelar

Skelar,
që vozit bregut menduar.
Të kujtohet një shkëmb brënda detit,
kur ishim fëmijë?
Tani në Skelë, nën rërë ai,
i harruar,
vëndi më fatlum i plazhit.

Dallgët gjithkaherë
e sulmuan.
E coptuan.
E thërrmuan.
E mbuluan.

Nga lodhja deti është larguar
i turpëruar.
Prandaj jam i grindur me detin.

Vlorë, 2-9-2008

Hija e tij

Ai e këqyrte hijen e tij
nëpërmjet skeletit
derdhur mbi rrasën e gurtë,
i zhveshur nga qejfi
për shkak të gjelbërimit.

Skeleti shkëlqente si foto nudo.
Në perëndim të Diellit
ai përqafon hijen të lënë diku më tej.
Hija lëkundesh sikur vallëzonte
me skeletin dritëtretur.

E mjeruar nga frika e skeletit
hija hesht….
Qetësohet në copëra jete,
që akoma ecin si më parë.

Arkivoli i Gjyshit

Arkivoli rrinte varur në punishte…

Në rrugicën e ngarkuar,
një kalimtar kërkonte një shtrat
për shtëpinë e tij syzgavruar.

Kalimtari mat me perin e syrit
arkivolin ngjyrë arre,
me emrin e njeriut,
që jetonte në punishte.

Ai nuk e dinte:
gjyshi e ruante për festën
e ditëvdekjes së tij…

Hëna dhe deti

Në të perënduar
këputa një copë diell,
ia dhurova detit.

Ndjeva të këputej heshtja…
Nga parregullsia e tingujve
u shfaqën dallgët e erës.

Nga lart dalngadalë
u qas hëna:
“Deti nuk mund të rrudhet,
deti ka aromën time,
deti fle me mua
në mbrëmje, deri në të gdhirë ».

Dhe peshqit marrin ngjyrën time…

16- Shtator, 2008

Atje lart...

Për të qenë në rehati,
ajo më ftoi t’i shijoja bukurinë e gjijve.
U ngjitëm lart…
Në tarracë nuk kishte dhoma dashurie.
Poshtë,
njerëzit bëheshin ngjyra.
Rrugët luanin muzikë me semaforët.
Ne të dy tingëllonim, duke numëruar
ngjyrat e kuqe…

24-9-2008

Ai ajër u bë i imi

Të gjitha stinët më çojnë te qyteti im…

Pasi ia mora shëmbëlltyrën,
ai ajër u bë i imi.

I zhveshur nga ëndrrat,
qetësohem dhe duartrokas vetveten.

Si ujë rëshqas drejt tij.

Gruaja labe smokthinjote

(Vasilika Sakaj-Çuri)

Një grua mbështjellë me dritë
këndon dollinë e jetës
me iso ngjyrë qielli,
me të folmen e bukur.
Dhe ajri, dhe uji,
dhe zjarri, dhe toka
puthen buzë më buzë.
Gjithçka rrezaton nga tingujt
dridhërues të isos,
shkunden dhe supet e vajzave.
Dhe sendet heshtin
nga këngët e gruas labe.

11-10 2008, Athinë

Fotografia e Shekspirit

Shekspiri –
fotografi gjigande
bardhë e zi, pa kornizë.
Hipur mbi kuajt e mbretërve
rend e rend nëpër shekuj.

Merreni!
Damkoseni!
Gjakoseni!
Kryqëzojeni Krishtin e Tragjedive!
Peshën e rëndë të fjalës
varjani në qafë fotografisë!

Nga fotografia në mure
dëgjohet klithma e kohës:
« Të rrosh a të mos rrosh? »
Në këtë botë me intriga,
mashtrime e tradhëtira….

Banesa

Nuk kam pallate dhe pasuri.
Banesën në gjoksin tënd e kam,
Atdhe!
I pasur me pamje
mbaj mbi shpinë vetveten.
I shkujdesur fle në ëndrrime,
duke bredhur nëpër udhët
dhe flokët ku jam shlodhur.
Nga shpirti i mençur i këngës
me buzëqeshje ndezëse
dëshiroj të shtroj sofrën me ajrin
e gëzimeve për njerëzit e mi…

Tetor, 2008

Cikli i katërt

Nata e dhimbjes

(Nëntor-Dhjetor-2008)

Fjalët

Kur fjalët bëhen re të zeza
e vijnë me pickama
në dritaren e shpirtit,
ato bëhen gra të përdala…

* * *

Buzë rrugëve të mjera
nuk jam unë mendimi yt,
është poezia shëmbëlltyra
e fjalëve
ardhur nga thellësia e syrit
a nga një botë tjetër .

Athinë 8-11-2008
ora20 e 40 minuta

Poetë të harlisur

Poetë të harlisur brigjeve të fjalës,
dhëndurë të poezisë syshkruar,
mos ma vrisni buzëqeshjen e varrit të nënës!
Nga cepat e vargjeve rrëshqasin lotë dhe shpresë,
jo copëra litari për fjalën e lirë.

8-11-2008
ora-21 e 15 minuta

Pagjumësia

Midis rrugëve të fjalës
sonte çapitem në pagjumësi.
E nesërmja do jetë e gjatë,
e gjatë është vetvetja.
Unë jam një hije
mbështjell me grimca drite,
me ngjyrë,
me shi.
Era e vjeshtës rend drejt meje,
më lëkund nëpër terrin e përçmimit,
ngritur mbi gërma të zeza mallkimi
duke më çukitur mbi kokë
me sqepin e fjalëve.

8-11-2008
ora-21^{e} 35 minuta

E shkriva moshën

Ia shkriva moshën Poezisë
për sy e për gjinj.
S'dua ta afroj stinën e bardhë
dhe pafuqinë e plakut.
Të lumtur më bën
oxhaku im i dashurisë.

8-11-2008
ora 23 e 10 minuta

Skeletet e fjalës

Mërmërimat treten diku…
Por unë rrugëtoj mendueshëm mbi to.
Kaluar mbi skelete fjalësh
trokas nëpër dyerët e pyllit
t'më shtrohet sofra
të ushqej skeletet e fjalëve
dhe syrin e uritur të poezisë.

Ajo

Ajo vuan e lumturuar,
rënkon e përçmuar,
e pabindur,
e babëzitur,
nën thundrën e mendimit.

E tillë shpupurishet nëpër ajër...

E ngrata,
e mjera fjalë!

Athinë-9-11-2008
ora 4^{e}30 minuta

Kokrra rëre

Kam në pëllëmbë të dorës kokrra rëre.
Me to luaj nëpër erën e vjeshtës.
I detyruar qëmtoj vështrimet e tyre,
ardhur diku nga buzë e detit.
Kokrra rëre të ndritshme,
të bardha rrëshqasin nëpër erë,
në pritje të një jete më të mirë.

16-Nëntor
2008-Athinë

Dëshira e kodrës

Kodra pak nga pak po jepte shpirt…
Dëshironte të bëhej lëndinë.

Atë kodër kur e kujtonte Ai,
mbushej me dëshpërim,
disa pika loti i rridhnin deri mbi buzë .

* * *

Shtëpitë flenë! Por,
askush s'guxon të hapë sytë
megjithëse dera është e çelur
të shohin lëndinën lakuriq…
rrethuar me fije bari .

Cikli i pestë

Poezi në kohë dimri

Pa titull

Kur ika nga Vlora,
e kyça detin në gjoksin tim,
të mos i dëgjoheshin jashtë meje rënkimet.

Kur më merr malli për të,
shtrydh gjoksin t'ia dëgjoj
këngët e fëmijërisë.

Kur…

Kur të më vijë koha e vdekjes,
nuk dua të më mburrrni,
as të më shani.
Një këngë himarjote më këndoni.

Kur të vdes,
nuk dua të heshtni,
një valle labërishte të rëndë

mbi varrin tim djalërishte ta hidhni.

Kur të më vijë ajo ditë,
nuk dua të më çoni në kishë!
Më çoni në një mbrëmje vallzimi,
të kërcej valsin e lumturisë.

6 Dhjetor, 2008

Gjethja

Në vjeshtë,
gjithë këto gjethe që bien,
ku venë vallë?
Tablo me ngjyra pemësh,
me gjethe mendimesh.

Gjethe në ajër
të përzëna nga era,
shtruar në tokë
dhe ca të zverdhura
në trungun e pemëve.

Gjethe mbi gjethe dhe përsëri gjethe,
ato nuk bëzajnë,
shumë kush i shkel me këmbë,
të tretura në tokën e lagët…
Përsëri riçelin gjethe mendimesh
në trungjet e pemëve…

Më prit…

Dua t'ia kreh flokët Vlorës,
bërë kurorë ulliri.

Sa herë kam dashur ta puth atë kurorë,
buzë detit,
pishave të Llogarasë,
përgjatë Vjosës,
majë Kuzbabait .

Në atë kurorë kam heshtur.
Mbi atë kurorë kam qeshur.
Nën atë kurorë kam qarë.
Për atë kurorë kam mall.
Më prit, më prit, Vlorë!

Drita

Në shumë vite,
mblodha një grusht
me dritë.

E dhurova...
E shpërndava…

Por ende
dritë nuk pashë.

Drejtësia e qiejve

Bota,
me muzikë tradicionale vdekjeje
inatin e qiejve e hodhi mbi vete.

Drejtësia e qiejve
dalë prej varresh shënjtërie
kumbon llahtarshëm
plot luftë shpërthyese,
me kufoma njerëzish.

Qiejt e shënjtëruar me gjëmime,
parreshtur rrëmbejnë shpirtra
në pafundësi.

Janar, 2009

Jeta

Jeta e bërë në shtatë copa,
si shtatë ditët e javës,
e koklavitur kërcen të shthuret
nëpër shkallët e javës.

Tani, në ditët e fundit
e mbaj shtërnguar nën sqetull
me kujdesin, se mos më largohet
dhe i vetëm ngelem nëpër shkallët e javës.

Një vajzë

Një vajzë e heshtur
kërkonte të thoshte një fjalë,
por nuk e thoshte dot.

Ajo, si e shushatur,
vajtonte fatin e lakuriqësisë,
me duar të njoma
xhepave të natës.

Vajza e mbërdhirë,
si natë me shi
ndihej e burgosur,
dalëngadalë i rrudhej fytyra.

Lagur,
thurrur me lotë nga frika e vizitorëve
nuk mundte t'i hapte krahët,
të shijonte bukurinë e shpirtit të saj
derdhur nëpër ajër.

Një djalë

Një djalit të plagosur në kujtesë,
nga ftohtësira e dimrit nuk i përthahen plagët
ngjyer me gjumin e mendimeve,
që koha i treti nën këmbët e turmave.

Ai tregon me sy
ku ndodhej zemreku
tashmë i braktisur i kujtesës.

Djalit, askush s'i thotë një fjalë,
por e shtyjnë në kurthe,
në mbrëmje të bëjë paqe
dhe të çlodhet në dimrin e vetmisë.

31 Janar 2009

Një grusht buzëqeshje për miqtë
(Me rastin e një vjetorit të «Degës së Blertë»)

Më zgjaten vështrimet e të gjallëve
dhe malli i të mërguarve.

Shkundem nga lemza e kujtimeve,
mbushur me gërma emrash
të padëgjuar.

Askush nuk na numëron.

Jetimë,
të rumbullakosur nga shpikja
që mbajmë mbi vete,
për të gatitur atë lëng me ngjyra
të jetës.

Mars, 2009 - Athinë

Në psiqiatri
(Sipas rrëfimit të shoqes time Mirela B.)

Drejt ullishtes vrapon si fëmijë,
i harruar nga mëshira e fatit.
Me dorën skelet jashtë kangjellave
diçka kërkon me përgjërim.

Me sy zgurdulluar dhe mendjen çalë
flokëpakrehur nga koha.
Gjymtyrëvarur pa shpresë
numëron makina dhe kalimtarë,

me mendje të çalë.
- Cigare! - thërret.
Dorëzgjatur fatit u thërret makinave
kalimtarëve ua bën me dorë.
- Cigare!…Ej, cigare!!!
- Cigareee !!! - thërret.

Manastiraq,
18-2-2009-Athinë

Pas të gjashtëdhjetave

Fanarët e udhëkryqeve

Fanarët e udhëkryqeve pyesin:
“ Pse s’e thoni emrin
e ëndrrave, që shikoni për natë,
mbi shtretërit të bërë qull?”

Pa kuptuar, po tretet gjumi,
bashkë me të edhe ëndrrat...
Nga qielli i grisur
syri i mëngjesit ka shumë etje.

Fanarët e udhëkryqeve,
përsëri pyesin:
“Pse se vrisni gjumin,
në të hyrë të ditës?”

I merakosur gjumi
ëndërron njeriun,
si natyrë, plotë dridhma,
syhapur kërkon të flejë...

Këngët e maliherit

Maliheri qethte silueta hijesh.
Kokëkrisur vajtonte eshtrat,
hedhur nëpër trungje.

Maliheri qëllonte
botën e përkëmbur,
me shpresë se do vdiste i bukur
në tokën e harruar.

Maliheri,
në ujdi me tymin e luftës,
kërkonte paqe me pemët .

Maliheri, i hutuar prej lotit
lëshonte breshëritë
për pranverën këmbëzbathur
të njerëzve të lodhur .

Pas të gjashtëdhjetave...

Në krahët e së nesërmes,
mes luksit të gjelbërimit,
me thjeshtësi jetoj si kitarë,
melodi mbledh në çdo stinë.

I përqafuar...
Udhëtoj me gjymtyrët e trupit
me fytyrë drejt bregut,
i zbardhur nga mjegulla e kohës,
tretur nëpër ngjyra dëshirash
për të nesërmen.

Pas të gjashtëdhjetave
qajnë gjethet për pak fat
drejt kopshtit me fruta
në ruajtje të kujtesës.

Fluturimthi

Më krisi në kokë
ngjyra e jetës sime...

Me jetën u takova në të gëdhirë.
M'u duk e gjatë
në fillim...

Nga kujtimet e viteve
dhe trokitjet e stinëve,
po vijnë...

... të më vjedhin duart
të ma marrin zemrën.

Sa e donte nëna diellin!

Sa e donte nëna diellin!
Dilte në kopsht dhe maste qiellin!
Më pastaj ujiste lulet
dhe borzilokun e babait.

Nëna mblidhte copëza drite
për fëmijët.
pranë sobës bukën thekte,
e heshtur thurte triko.

Sa i shkonte nënës buzëqeshja!
Shtrinte krahët të fshinte lotët e mendimeve.
Flladi i mbrëmjes
të gjithë bashkë na mblidhte .

Në ëndrrën time

Asaj,
nga një poezi e syrit tim
iu zbardh fytyra .
Ajo,
sipas dëshirës shpërngulur nëpër vise
kaluar hipën dhe zbret shkallët e përkëdheljeve
të lojës me muzikë poetike .
Kështu,
më afrohet fluturimthi të ngjyej syrin e poezisë nga malli
i largët i dashurisë në ëndrrën time lindur nga gjurma e shpresës
dhe me gaz këndoj përsëri poezi .

Poeti i mesazheve njerëzore

(Shprehet Vangjel Pici,

krijues, mësues letërsie i shumë brezave)

Në librin ‘’ Gratë e poetëve’’ poezia e Arqile Gjatës është brenda njësisë së saj, e ngjeshur në vetvete me atë mendim dhe figuracion vetjak. Vizjonet e autorit janë të befasishme dhe lëvizin tërë gjallëri nëpër vargje. Edhe pse një pjesë e tyre duken si të mbyllura, përsëri të ftojnë të meditosh pak dhe më pas të marrësh me vete ndjenjat e përfytyrimet e ngrohta të vargjeve. Poeti me pak vargje pushton një mendim të tërë plot reagime, përleshje dhe gëzime.
Që të gjitha poezitë janë shpërthime të çastit dhe të gjitha janë tokësore, sepse janë njerëzore, burojnë nga uni i tij, që është pjesë e gjithësisë. Në trungun e poezive lëviz një tematikë e gjërë, që niset nga qielli dhe pastaja mbyllet te Sheshi i Kateqit dhe te kënga smokthinjote.

Atdheu është nyja që e mbanë të lidhur poetin me tokën, me detin e Vlorës, me njerëzit e tij më të dashur, dhe pse jeton jashtë Atdheut. Mendja dhe zemra e tij bredhin ullishteve të vendlindjes dhe brigjeve të atij deti të veshur me perndimet ngjyrë portokalli. Ky mesazh e bënë autorin të jetë krenar për atë tokë, ku lindi dhe ëndëron të vdes.
Ndër gjithë poezitë e librit spikasin vargjet e poezive ‘’ Banesa’’, ‘’Pa titull’’, ‘’ Gratë e poetëve’’, ‘’ Poetë të harlisur ‘’, ‘’Në ditëlindjen tënde’’, ‘’Për Mësuesin’’, ‘’Ai ajër u bë imi’’, ‘’Skelar’’ e tjera, që, për kkthjellësinë e mendimeve dhe ndjeshmërinë njerëzore, përçojnë te lexuesi emocone të veçanta.
Këto poezi sëbashku me të tjerat krijojnë peisazhin e kopshtit poetikë të Arqiles, të këtij njeriu të ndershëm, të urtë e tërë energji të brendëshme e pasion për letërsinë artistike.

Kopertina (Ballina) e pasme

1- fotografia
2- Një poezi

Me jetën u takova në të gëdhirë .
M’duk e gjatë
në fillim…

Nga kujtimet e viteve
dhe trokitjet e stinëve,
po vijnë…
…të më vjedhin duartë
të më marrin zemrën .

3- Botimet e autorit

_ Aristidh Kolia Arvanitas me shumë emër (monografi) viti-2000
_ Kur trazohet jeta . Vëllim poetikë viti-2005
_ Kurorë me ngjyra . Vëllim poetikë viti-2006
_ Qytqeti që kërkon muzikë Vëllim me tregime viti-2008